

RELACION TEKNIK KONTRATA II
(PROJEKT ME PERSHKRIM)

Mirëmbajtje me performancë: 1. K/ Muzinë - Delvinë (15 km), 2. Delvinë – Qafë Gjashtë (13.2 km), 3. Ura Kardhiq - Prongji (7.2 km), 4. K/Shijan - Vergo (9.2 km), 5. Prongji - Vergo (Loti 4+5+6) (14.5 km) (Kontrata II, total 39.4 km)

1. Qëllimi i Shërbimeve që do kryhen

Shërbimet që do mundësohen përfshijnë gjithë veprimtaritë, fizike dhe të tjera, që duhet të kryhen, sipas përputhshmërisë së tyre me Nivelet e Shërbimit dhe kriterin e caktuar të realizimit të tyre të performancës, apo me çdo kërkesë tjetër.

Në vecanti, ato përfshijnë detyrat menaxheriale dhe punimet fizike që lidhen me asetet dhe zërat që lidhen me rrugën:

- Asfaltimet
- Bankinat
- Sinjalistika dhe furnizimi pajisjet për sigurinë rrugore
- Strukturat e drenazhimit
- Kontrolli i vegjetacionit
- Skarpatat (gërmimet dhe bankinat)
- Veprat e artit
- Menaxhimi i trafikut
- Grumbullimi i dherave
- Pastrimi i dëborës (nqs ka mirëmbajtje dimërore)

Shërbimet që kërkon Mirëmbajtja e një rruge klasifikohen në:

2. Punimet Rehabilituese/periodike, në formën e sasisë së një vlere tavan, ndërsa tregohen sasi të punimeve të matëshme që do kryhen në mënyrë që rruga të arrijë Standardet e asaj performancë.
3. Shërbimet e Mirëmbajtjes Rutinë në formën e sasisë së shprehur në një vlerë tavan mujore (kjo do jetë një sasi mujore e aplikueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së shprehur në çmim për kilometër për secilin muaj e shumëzuar me gjatësinë e rrugës dhe kohëzgjatjen e shërbimeve);
4. Punimet Emergjente në formën e një preventivi tradicional.

Funksionet kryesore të bazave të mirëmbajtjes në përgjithësi, duhet të jenë si më poshtë:

1. Mbikëqyrja e segmentit/seksionit rrugor në periudha të caktuara sipas niveleve të shërbimit
2. Kontrolli i të dhënave të trafikut për këtë segment
3. Vëzhgimi i faktorëve meteorologjikë
4. Ndihma e parë në rast aksidenti (në lidhje me elementët e rrugës dhe trafikut)
5. Mirëmbajtje në kushtet e dëshiruara të shtresave rrugore
6. Mirëmbajtja e hapësirave të parkimit, shërbimit, shenjave rrugore, sistemeve të ndriçimit, sinjalizimit të ardhshëm e telekomunikacionit.
7. Riparime dhe rindërtim pas aksidenteve rrugore
8. Riparime dhe rindërtim pas fatkeqësive natyrore

9. Operacionet e pastrimit të drenazheve, tombinove dhe objekteve të tjera që lidhen me largimin e ujrave nga sipërfaqja e rrugës

10. Të gjithë operacionet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e :

- shenjave rrugore, pajisjeve të sigurisë (gardhe, parapet) sistemi i ndricimit.
- riparimi lokal i dëmtimeve të trotuarit
- kujdesi për bimesinë
- aktiviteti në dimer për largimin e dëborës dhe akullit.

Punimet e mirëmbajtjes në kushtet dimërore, përfshijnë:

1. Punime paraprake para fillimit të kushteve të dimrit
2. Organizimi i vendodhjeve të depozitimit të materialeve
3. Masat mbrojtëse për borën, akullin, grumbujt e borës dhe ortekët
4. Pastrimi i dëborës nga karrexhata e autostrades dhe sinjalet e komunikacionit dhe shenjat
5. Shenjimi i anëve të karrexhatës
6. Sigurimi i funksionimit të drenazhimit nga karrexhata
7. Heqjen e automjeteve nga rruga
8. Instalimi i sinjaleve të vecanta të komunikacionit në rastet e rregjimit të trafikut të veçantë të mbylljes së rrugës.
9. Informimi i vazhdueshëm i publikut për gjendjen e rrugës dhe rrjedhën e trafikut.

5. Segmentet që mbulon kontrata

Nr. Rrugës	Nr. Redor	Emërtimi i Rrugëve	Tipi rrugës	Gjatësia totale (km)	Gjerësia (m)
78	1	K/ Muzinë - Delvinë	SHL	15	6
99	2	Delvinë – Qafë Gjashtë	SHL	13.2	9
S'ka	3	Ura Kardhiq - Prongji	SMTW	7.2	9.5
S'ka	4	K/Shijan - Vergo	SMTW	9.2	9.5
S'ka	5	Prongji - Vergo (Loti 4+5+6)	SMTW	14.5	9.5
`SHUMA KONTRATA II				59.1	

Shënim: SFL – rrugë në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore, SHL – rrugë në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore, SMTW – rrugë në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.

6. Kusht i veçantë


Për çdo rast, nga kontrata do të zbriten segmente të saj nqs do të përfshihen në investim (rikonstruksion) apo projekte të tjera të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

7. Sinjalistika dhe siguria rrugore

Mirëmbajtja e sinjalistikës dhe siguria rrugore (barrierat) do të fokusohet tek riparimi dhe rifreskimi e asaj ekzistuese.

8. Përshkrimi i zonës, Skica dhe Relacion teknik.

1: K/ Muzinë - Delvinë (15 km)



Delvinë
39.954635, 20.102385

K/ Muzinë
39.933873, 20.203476

Relacion teknik: Aksi rrugor K/ Muzinë - Delvinë (15 km)

Emërtimi: K/ Muzinë – Delvinë

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje

Gjatësi: 15 km

Gjerësi: 6 m

Koha e ndertimit: rrugë e vjetër.

Mbi rëndësinë e aksit: rrugë ndërqytetëse (interurbane dytësore, kategoria C) që lidh Sarandën, Delvinën dhe Gjirokastrën si dhe fshatrat ndërmjet tyre.

Lidhur me gjeologjinë, gjeologjinë inxhinjerie dhe hidrogjeologjinë: Formacione të qendrueshme. Aksi permban vepra arti e mure mbajtës e pritës, të nevojshëm. Ka tendence gërryerje në këmbët e urave të gurit nga uji në përrrenjtë prandaj është i nevojshëm kontrolli i vazhdueshëm. Në kilometrin 22 deri 24, formacione të gërryeshme nga ujrat sipërfaqësorë, me tendencë gërryerjen e shpatit të poshtëm (të majtë) të rrugës.

Mbi elementet kryesorë të rrugës:

Trupi i rrugës: Shtresa asfalti me penetrim, të amortizuara plotësisht.

Bankinat, kanalet, kanë nevojë për mirëmbajtje rutinë


Skarpatet të qëndrueshme

Veprat e artit në funksion normal

Nuk ka patë dhe nuk ka sinjalistikë pasi është aks i amortizuar dhe numri i mjeteve në orë është i rrallë.

Në tërësi aksi rrugor ka nevojë për mirëmbajtje rutinë.

2: Delvinë – Qafë Gjashtë (13.2 km)



Relacion teknik: Aksi rrugor Delvinë – Qafë Gjashtë (13.2 km)

Emërtimi: Delvinë – Qafë Gjashtë

Gjatësi: 13.2 km.

Segmenti Delvinë – Ura e Gajdarit, 11.9 km, është me gjerësi 6 m, me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Segmenti Ura e Gajdarit – Qafë Gjashtë, 1.3 km është me gjerësi 9 m, me dy karrexhata. Karrexhata në të djathtë me dy korsi lëvizjeje vajtje dhe karrexhata në të majtë me një korsi lëvizjeje kah i kundërt.

Koha e ndërtimit: rrugë e vjetër ndërsa segmenti Ura e Gajdarit – Qafë Gjashtë, rikonstruksion i vitit 2018.

Mbi rëndësinë e aksit: rrugë ndërqytetëse (interurbane dytësore, kategoria C) që lidh Sarandën, Delvinën si dhe fshatrat ndërmjet tyre. Aksi rrugor i rëndësishëm nga pikëpamja ekonomike, shoqërore dhe turistike.

Lidhur me gjeologjinë, gjeologjinë inxhinjerie dhe hidrogjeologjinë: Formacione të pëziera si zona me dhera aluviale kryesisht në zonën fushore përgjatë lumit Kalasë, formacione shtufi, etj.

Aksi përmban vepra arti e mure mbajtës e pritës, të nevojshëm.

Mbi elementet kryesore të rrugës:

Trupi i rrugës: Segmenti Ura e Gajdarit – Delvinë, e asfaltuar por ka nevojë për mirëmbajtje të shtresave. Bankinat, kanalet, kanë nevojë për mirëmbajtje rutinë. Sinjalistika ka nevojë për plotësim si dhe plotësim me guardraile në segmente të veçanta.


Kurse segmenti Ura e Gajdarit – Qafë Gjashtë është asfalt i ri në gjendje shumë të mirë. Segment me ndriçim, me trotuare, me kuletë dhe sinjalistike të plote, në gjendje të mirë.

Skarpatet të qëndrueshme

Veprat e artit në funksion normal

3: Ura Kardhiq - Prongji (7.2 km)

Prongji
[40.125830](#),
[20.020946](#)



Ura Kardhiq
40.147348,
20.095997

Relacion teknik: Aksi rrugor Ura Kardhiq - Prongji (7.2 km)

Emërtimi: rruga Ura Kardhiq – Prongji

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje

Gjatësi: 7.2 km

Gjerësi: 9.5 m (7 m + 2 x 1.25 m)

Koha e ndertimit: Në ndërtim.

Mbi rëndësinë e aksit: rrugë interurbane dytësore, kategoria C. Lidh Sarandën dhe Delvinën me Gjirokastrën, Tepelënen, Fierin, Lushnjën, Kavajën, Durrësin, Tiranën etj. Ka rëndësi të madhe ekonomike, sociale dhe turistike

Lidhur me gjeologjinë, gjeologjinë inxhinjerie dhe hidrogjeologjinë: Projekti parashikon zgjidhjet përkatëse, kilometër pas kilometri për të gjitha kushtet reale të elementëve të mësipërm.

Mbi elementet kryesore të rrugës:

Trupi i rrugës: Shtresat e asfaltit janë parashikuar Konglomerat Bituminoz 8 cm, Binder 6 cm dhe Veshje 4 cm. Nga te cilat janë realizuar 2 shtresat e para dhe mungon Veshja 4 cm.

Kunetat, nuk egzistojne pasi nuk është hedhur shtresa e veshjes me asfalt. Bankinat, janë me asfalt 2 x 1.25 m por mungon shtresa e veshjes. Kanalet, janë në gjëndje të mirë dhe kanë nevojë për mirëmbajtje rutinë.

Skarpatet të qëndryshme por nga kilometri 4.8 deri në kilometrin 5.2, ka rënie dherash nga skarpatet ne germim te cilat kalojne muret pritesese te betonit dhe arrijne brënda rrugës. Muret e betonit, mbajtes e prites jane ne gjëndje te mire. Ka nevojë për mirëmbajtje rutinë.


Veprat e artit në funksion normal

Sinjalistika mungon si objekt ne ndertim. Ka nevojë për vendosje të sinjalistikës.

Në tërësi aksi rrugor është aks në ndërtim dhe ka nevojë , thjesht, për mirëmbajtje rutinë.

4: K/Shijan - Vergo (9.2 km)

Vergo
39.998067,
20.006618



K/Shijan
39.922957,
20.040162

Relacion teknik: Aksi rrugor K/Shijan - Vergo (9.2 km)

Emërtimi: rruga Kardhiq - Delvine Loti 2 dhe 3
Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje
Gjatësi: 9.2 km

Gjerësi: 9.5 m (7 m + 2 x 1.25 m)

Koha e ndërtimit: Në ndërtim.

Mbi rëndësinë e aksit: rrugë interurbane dytësore, kategoria C. Lidh Sarandën dhe Delvinën me Gjirokastrën, Tepelënen, Fierin, Lushnjën, Kavajën, Durrësin, Tiranën etj. Ka rëndësi të madhe ekonomike, sociale dhe turistike

Lidhur me gjeologjinë, gjeologjinë inxhinjerie dhe hidrogjeologjinë: Projekti parashikon zgjidhjet përkatëse, kilometër pas kilometri për të gjitha kushtet reale të elementëve të mësipërm.

Mbi elementet kryesore të rrugës:

Trupi i rrugës: Është ngritur për 4 kilometrat e para mbi argjinaturë dhe pjesa tjetër në bazament me gërmim dhe mbushje. Nga shtresat e asfaltit janë parashikuar Konglomerat Bituminoz 8 cm, Binder 6 cm dhe Veshje 4 cm. Nga të cilat janë realizuar 2 shtresat e para dhe mungon Veshja 4 cm.

Kunetat, nuk ekzistojnë pasi nuk është hedhur shtresa e veshjes me asfalt. Bankinat, janë me asfalt 2 x 1.25 m por mungon shtresa e veshjes. Kanalet, janë në gjëndje të mirë dhe kanë nevojë për mirëmbajtje rutinë.

Skarpatet të qëndrueshme por nga kilometri 7.8 deri në kilometrin 8.0 ka rënie dherash brenda rrugës. Ka nevojë për mirëmbajtje rutinë.


Veprat e artit në funksion normal

Sinjalistika është minimale si objekt në ndërtim. Ka nevojë për vendosje të sinjalistikës.

Në tërësi aksi rrugor është aks në ndërtim dhe ka nevojë , thjesht, për mirëmbajtje rutinë.

2.5: Prongji - Vergo (Loti 4+5+6) (14.5 km)

Prongji
40.125830,
20.020946



Vergo
39.998067,
20.006618

Relacion teknik: Aksi rrugor Prongji - Vergo (Loti 4+5+6) (14.5 km)

Emërtimi: rruga Prongji – Vergo

Do të jetë segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje

Gjatësi: 14.5 km

Gjerësi: 9.5 m (7 m + 2 x 1.25 m)

Koha e ndërtimit: Një ndërtim.

Mbi rëndësinë e aksit: rrugë interurbane dytësore, kategoria C. Lidh Sarandën dhe Delvinën me Gjirokastrën, Tepelënen, Fierin, Lushnjën, Kavajën, Durrësin, Tiranën etj. Ka rëndësi të madhe ekonomike, sociale dhe turistike

Lidhur me gjeologjinë, gjeologjinë inxhinjerie dhe hidrogjeologjinë: Projekti parashikon zgjidhjet përkatëse, kilometër pas kilometri për të gjitha kushtet reale të elementëve të mësipërm.

Mbi elementet kryesorë të rrugës: Aktualisht punime gërmimi, mure b/a, etj.

Aks në ndërtim ku është parashikuar ndërtim Tuneli, ura b/a, etj